



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:126551

Datë: 06.02.2024

Numri i dokumentit: 05287221

P.nr.1521/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, gjyqtari Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V.Mi akuzuar sipas aktakuzave, PP.II.nr. 2561/22 të datës: 14.06.2022, PP.II.nr. 2087/23 të datës: 23.03.2023, PP.II.nr. 2306/22 të datës: 25.05.2022, PP.II.nr. 3611/23 të datës: 29.06.2023, së Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamenti i Përgjithshëm, për shkak të veprave penale “Mashtrim” nga neni 335. par.1, të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të datës: 30.01.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Besnik Jakupi, mbrojtësi i të akuzuarit sipas detyrës zyrtare Avokat Hamdi Jashanica, si dhe i akuzuari V.Mkurse me datë: 02.02.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë: 05.02.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.M i biri i A dhe E, e gjinisë S, i lindur me datë “data e lindjes”, në Prishtinë ku edhe jeton në rr. “emri i rrugës”, nr..., i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, i pa punë, me nr. personal “letërnjoftim”, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I. Me datë 30.04.2022, rreth orës 13:00 në rr. “Garibaldi” në Prishtinë, i pandehuri me anë të paraqitjes së rrem të fakteve dhe me anë të lajthimit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë, e venë në lajthim të dëmtuarën D.R, duke nxitur që të veproj në dëm të pasurisë së saj, në atë mënyrë që e mashtron duke hyrë në lokal kinse për ta blerë një parë syze dhe posa e shikon, kërkon nga e dëmtuara që të ia mundësoj që të merr syzet të tipit “Dolce Gaban”,ngjyrë të zezë, me qëllim që të i provoj dhe pas 10 minutash të ia sjell parat për pagesë, i njëjti i merr syzet dhe nuk është kthyer me dhe as nuk i është lajmëruar të dëmtuarës në as një formë, më çka të dëmtuarës i shkakton dëm material në shumë prej 350 euro.

- Me këtë i pandehuri kishte për të kryer veprën penale Mashtrimi nga neni 323 paragrafin 1 të KPRK-së.

II. Me datë 22.01.2023, rreth orës 14:50, në Prishtinë, i pandehuri me anë të paraqitjes së rreme të fakteve dhe duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten ka mashtruar B.M, tani i dëmtuar, në atë mënyrë që i ka kërkuar të dëmtuarit që ti merr me vete 12 thasë patate e kinse të ja sjellë paratë pas 10 minutave, por pas largimit nuk është paraqitur më tek i dëmtuari për të realizuar pagesën apo kthimin e tyre, me ç’ ka i ka shkaktuar dëm material të dëmtuarit në vlerë rreth 50 euro,

-me këtë ka kryer veprën penale *Mashtrimi, neni 323, paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1*, Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-74.

III. Ekziston dyshimi i bazuar mirë se me dt. 15.04.2022, rreth orës 13:45, në rr. “Peja”, në Fushë Kosovë, gje gjësisht në lokalit “Emri i lokalit”, i pandehuri me qëllim që vetës apo personit tjetër ti sjell dobi pasurore të kundërligjshme e ka sjellë në lajthim të dëmtuarin F.RR, dhe e ka shtyrë të veproj në dëm të pasurisë së tij me paraqitje të rrejshme të fakteve duke mashtruar të njëjtin nga ai e ka marrë një (AKU), me pretekstin se të njëjtin do ta shikoj vëllai i tij i cili gjendet në banesë afër këtij lokalit , e më pas atë do ta kthej pas 30 minutave ,mirëpo i pandehuri posa e ka marrë mjetin e lartcekur është larguar në drejtim të panjohur duke mos ja kthyer atë të dëmtuarit, me ç’ rast të njëjtit i shkaktonte dëm të material në vlerë prej 100(njëqind euro),

- Me këtë ka kryer veprën penale “Mashtrimi” nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

IV. Me datë 09.05.2023, rreth orës 20:45, në Prishtinë, i pandehuri V.M me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore në mënyrë të kundërligjshme për vete apo personin tjetër, të dëmtuarit R.Z, ia ka marrë dy duksa - bluza, në atë mënyrë që pasi i pandehuri kishte hyrë brenda në lokalit “emri i lokalit” i cili gjendet në sheshin “Skenderbeu” kishte marrë dy duksa dhe i kishte kërkuar leje nga rojtari i lokalit A.M, dhe nga arkëtarja e lokalit duke iu thënë “ a bënë të dal jashtë t’ia dërgoj djalit me i provua se është i lënduar dhe nuk mund të vijë”, dhe pasi që i kanë dhënë leje të lartpërmendurit, i pandehuri është larguar së bashku me duksat dhe më nuk është kthyer, me ç’ rast të dëmtuarit R.Z, i ka shkaktuar dëm pasuror në vlerë prej 77 (shtatëdhjetë e shtatë) euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale, “Mashtrimi” nga neni 323 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve të lartcekur dhe neneve 1, 4, 7, 17, 20, 21, 38, 39, 42, 43, 69, 70 të KPRK-së dhe neneve 241, 242 par.2, 364 dhe 365 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

#### DENIM ME BURGIM dhe DENIM MË GJOBË

- Të akuzarës V.M për veprën penale si në piken I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim prej katër (4) muaj, për veprën penale si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim prej tre (3) muaj, për veprën penale si në piken III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim prej tre (3) muaj, për veprën penale si në piken IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim me burgim prej tre (3) muaj.

- Të akuzuarës për veprën penale si ne piken I të dispozitivit, i shqipton dënim me gjobë me 150 € (njëqind e pesëdhjetë), euro, për veprën penale si ne piken II të dispozitivit, i shqipton dënim me gjobë me 150 € (njëqind e pesëdhjetë), euro, për veprën penale si ne piken III të dispozitivit, i shqipton dënim me gjobë me 150 € (njëqind e pesëdhjetë), euro, për veprën penale si ne piken VI të dispozitivit, i shqipton dënim me gjobë me 150 € (njëqind e pesëdhjetë), euro. dënim të cilin e akuzuara obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Në harmoni me nenin 76 paragrafi.1, par.2 pika.2.2, 2.4 të KPRK-së, i shqipton:

### DËNIM UNIK

- Të akuzuarit për veprat penale si në piken I, piken II, piken III, piken IV, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Të akuzuarit për veprat penale si në piken I, piken II, piken III, piken IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton dënim unik me gjobë në shumen 600 (gjashtëqind) Euro, dënim të cilin i akuzuari, obligohet te paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- Nëse i akuzuari nuk e paguan dënimin e shqiptuar, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgim duke e llogaritur, 20 (njëzet) Euro me 1 (një) ditë burgim.
- Të akuzuarit koha e kaluar në paraburgim dhe atë nga data: 24.05.2022 e deri me datë: 24.06.2022, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar, konform nenit 80 par.1 të KPRK-së.
- Palët e dëmtuara, D.R nga Gjakova, rr. “emri i rrugës”, në Gjakovë, B.M më vendbanim në “vendbanim”. F.R me vendbanim në rr. “emri i rrugës”, objekti “emri i objektit” hy. “nr. i hyrjes” nr. “...” Fushë Kosovë, A.M, me vendbanim në fshatin “fshati”, komuna e Obliqit, lidhur me realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko – civil.
- Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet procedurës penale aq sa do të llogaritet sipas shpenzim orës përfundimtare të gjykatës, Obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjete), dhe shumën prej 20 € (njëzetë euro), për fondin e viktimave të krimit, si dhe të gjitha shpenzimet e tjera eventuale të procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë pasi ky aktgjykim paraqet titull përmbarimor.

## A R S Y E T I M

### Rrjedha e procedurës, Historiku:

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzat PP.II.nr. 2561/22 të datës: 14.06.2022, PP.II.nr. 2087/23 të datës: 23.03.2023, PP.II.nr. 2306/22 të datës: 25.05.2022, PP.II.nr. 3611/23 të datës: 29.06.2023, ndaj të akuzuarit V.M për shkak të veprave penale “Mashttrim” nga neni 335. par.1, të KPRK-së.

### Kompetenca e gjykatës:

Gjykata Themelore në Prishtinë, pas pranimit të aktakuzës, ka bërë vlersimin e kompetencës, andaj duke u bazuar në nenin 29 paragrafi.1 të KPPRK-së, ka kompetencë territoriale për ta gjykuar këtë çështje, për arsye se veprat penale janë kryer në Prishtinë e që bie në kompetencë territoriale të kësaj Gjykate. Duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Gjykatat, Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore, është kompetentë për ta gjykuar një çështje, ku e akuzuara akuzohet për shkak të veprave penale, “Mashttrim” nga neni 335. par.1, të KPRK-së, e cila vepër është e dënueshme deri në 3 (tri) vite burgim, andaj gjykimi i këtyre veprave, bije në kompetencë lëndore të këtij departamenti.

### Bashkimi i procedurës penale:

Gjyqtari i çështjes pasi që ka pranuar, ka bërë analizimin e aktakuzën PP.II.nr. 2561/22 të datës: 14.06.2022, po ashtu ka vërejtur se ndaj të akuzuarit V.M, Prokuroria Themelore në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin e përgjithshëm, divizioni penal, ka ngritur edhe aktakuza të tjera, për veprat penale “Mashttrim” nga neni 335. par.1, të KPRK-së, andaj mbi bazën e kësaj dhe në harmoni me nenin 35 par.5, 6, 7 dhe 8, të KPPRK-së, më qëllim të ekonomizimit të procedurës penalë, me aktvendimin P.nr. 1521/22 të datës: 30.01.2024, ka bërë bashkimin e procedurës kundër të akuzuarit V.M, PP.II.nr. 2087/23 të datës: 23.03.2023, PP.II.nr. 2306/22 të datës: 25.05.2022, PP.II.nr. 3611/23 të datës: 29.06.2023, ndërsa pas bashkimit të procedurës penale lënda barte shenjen, P.nr. 1521/22.

### Shqyrtimi gjyqësor:

Lidhur me këtë çështje, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë: 30.01.2024, ka mbajtur shqyrtimit fillestar në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Besnik Jakupi, mbrojtësi i të akuzuarit sipas detyrës zyrtare Avokat Hamdi Jashanica, si dhe i akuzuari V.M. . Të akuzuarit, pasi që janë lexuar të drejtat e tij në harmoni me nenin 241 të Kodin e Procedurës Penale nga ana e gjykatës, ka theksuar se donë që të deklarohet.

I akuzuari, V.M në seancën e shqyrtimit fillestar, pohon se dua të deklarohem: “Për këtë aktakuzë PP/II.nr. 2561/22, e datës 14.06.2022 pranoj se jam fajtor, ndihem i penduar me nuk do ta përsërisë me. I pandehuri pohon se dua të deklarohem, dhe për këtë aktakuzë PP/II.nr. 2087/23, e datës 23.03.2023 pranoj se jam fajtor, ndihem i penduar me nuk do ta përsërisë me. I pandehuri pohon se dua të deklarohem, dhe për këtë aktakuzë PP/II.nr. 2306/22, e datës 25.05.2022 pranoj se jam fajtor, ndihem i penduar me nuk do ta përsërisë me. I pandehuri pohon se dua të deklarohem, dhe për këtë aktakuzë PP/II.nr. 3611/23 e datës 29.06.2023 pranoj se jam fajtor,

*ndihem i penduar me nuk do ta përsërisë me, po ashtu ka deklaruar se të gjitha veprat penale i pranoj kam qene ne krize dhe me nuk do ti përsëris”.*

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. Hamdi Jashanica në lidhje me pranimin e fajësisë nga e pandehura deklaroi: *“Pas konsultimit dhe informimit në tërësi lidhur me rrethanat e qështje për aktakuzat për të cilat akuzohet i mbrojturi im dhe pranimin e tyre nga ai e mbështes deklaratën e të mbrojturit tim dhe konsideroj se pranimi i fajësisë pendimi keqardhja dhe premtimi ndaj gjykatës se nuk do ti përsërisë me veprat këto janë virtyte të larta njerëzore dhe i propozoj gjykatës se me rastin e matjes së caktimit të dënimit të i vlerësoj dhe ti marre në konsiderate dhe gjithashtu desha të potencoj faktin se vet pranimi i fajësisë në këtë fazë të procedurës është sinjal i mirë për përmirësim dhe risocializim dhe besoj që gjykata do ta vlerësoj të njëjtin”.*

Sa i përket pranimin të fajësisë nga e akuzuara, Prokurori i Shtetit Besnik Jakupi deklaroi se: *“Pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit duke e konsideruar se pranimi i fajësisë është bere ne përputhje me nenin 242 të KPPRK-së ashtu që i pandehuri është konsultuar mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi është bere ne mënyre vullnetare pa presion duke i kuptuar benefitet e pranimin të fajësisë si dhe i njëjti mbështet ne provat që ndodhen në shkresat të lëndës dhe aktakuzat nuk përmbajnë shkelje ligjore. Prandaj gjykatës i propozoj që pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ta pranoj ashtu që të njëjtin ta shpalle fajtor për veprat penale sipas aktakuzave ndërsa në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata të merr si rrethana renduese faktin se i pandehuri është recidivist i veprave penale të llojit të njëjtit duke vepruar në mënyrë mashtruese me qellim të përfitimit pasuror ndërsa si rrethane lehtësuese të merr për baze pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit”.*

Andaj pas pranimin të fajësisë nga i akuzuari dhe deklarimit të prokurorit të shtetit, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, po ashtu pranimin e fajësisë e ka bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafi.1 të KPPRK-së. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 242 par.1 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

#### Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale:

Se i akuzuari V.M me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzave së ngritura ndaj tij, ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, në atë mënyrë siç përshkruhet në dispozitiv të aktakuzave të cilat i vihen në barrë. Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, për veprimet e tilla, si dhe prokuroria e shtetit e ka aprovuar pranimin e fajësisë, është vërtetuar që janë përberë në tërësi elementet e veprave penale, “Mashtrim” nga neni 335. par.1 të KPRK-së. Gjykata nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e tij, si dhe deklarimi i prokurorit duke e pranuar pranimin e fajësisë, e po ashtu nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzave

së ngritur ndaj tij, ka kryer veprat penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka konstatuar se janë përmbushur elementet e veprave penale të cilat i vihen në barrë sipas aktakuzës.

#### Shqiptimi i sanksionit penale:

Gjykata me rastin e matjes së dënimit mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, premtimin para gjykatës se nuk do ti përsëris veprimet e ngjashme, ndërsa rrethana rënduese gjeti veprat janë kryer në shumë lokacione të ndryshme, si dhe i njëjti është recidivist, andaj të akuzuarit i shqiptohet dënimi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pasi që i akuzuari me veprime të kundërligjshme ka shkaktuar dëm palëve të dëmtuara, me qëllim që veti të i sjell dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, ashtu siç është përshkruar në dispozitivat të aktakuzave të cilat i vihet në barrë për veprat penale “Mashtrim” nga neni 335. par.1 të KPRK-së. Të akuzuarit i shqipton dënim unik i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. po ashtu i shqipton dënim unik me gjobë në shumën 600 (gjashtëqind) Euro, dënim të cilin i akuzuari, obligohet të paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

#### Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim:

Vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim, ndaj të akuzuarit nga data: 24.05.2022 e deri me datë: 24.06.2022, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar, konform nenit 79 par.1 të KPRK-së. ku citohet se: *“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë”*.

#### Vendimi mbi udhëzimin e palës në kontest të rregullt juridiko-civil:

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko civil është mbështetur në nenin 462 par 2 të KPPRK-së. ku nga paragrafi 2. Citohet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”*.

#### Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1, dhe par.2 të KPPRK-së. ku nga paragrafi 1. citohet se: *Kur gjykata e shpall të akuzuarin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës*

*penale*. ndërsa lidhur taksën për programin e kompensimit të viktimave u mor konform nenit 39 par 3, pika 3.1, të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit (Ligji nr. 05/L036).

Baza ligjore mbi të cilën u vendos sipas këtij aktgjykimi:

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të 1, 4, 7, 17, 20, 21, 39, 39, 40, 42, 43, 69, 70, të KPRK-së dhe neneve 241, 242 par.2, 364 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal  
P.nr.1521/22, datë: 05.02.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Asdren Selmani

Gjyqtari,  
Sabit Sadikaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (30) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.